

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR

LËNDA:GJUHË FRËNGE

(klasa e shtatë)

Tiranë, 2005

1. Hyrje

2. Synime edukative dhe objektiva didaktikë

- a. Synime edukative
- b. Objektiva didaktikë

3. Përshkrimi i katër aftësive gjuhësore

4. Struktura sintetike e programit

5. Struktura analitike e programit

- a. Temat
- b. Aktet dhe funksionet e komunikimit
- c. Strukturat gramatikore

6. Udhëzime didaktike

7. Metodologjia e vlerësimit dhe e vetëvlerësimit

8. Kriteria për hartimin e tekstit

1. HYRJE

Në kuadrin e ndryshimeve të sistemit shkollor, plani mësimor i gjuhës frënge në klasën e 7-të të zhvillohet me 2 orë në javë. Programi i këtij niveli merret e trajtohet si rimarrje e njohurive dhe shkathtësive të përfutuara në klasat III-VI, duke u plotësuar me informacion të ri.

Mësimi i gjuhës së huaj bëhet nëpërmjet zbulimit të kulturës dhe të qytetërimit francez bazuar në dokumente autentike, në dialogje, situata të ndryshme të përshtatshme për këtë grup-moshë.

Integrimi i vendit tonë në gjirin e familjes evropiane kërkon njohje dhe zotërim të efektshëm të gjuhës së huaj. Një veprim i tillë u krijon mundësi nxënësve të arrijnë shpejt një autonomi të përdorimit të gjuhës frënge nëpërmjet mjeteve të nevojshme për një komunikim imediat, duke favorizuar rastet kur ai ndjehet i gatshëm për t'u shprehur dhe për të komunikuar. Nga kjo linjë dalin tri ide kryesore:

- Gjuha është një mjet komunikimi.
- Nxënësi ndjen nevojën të favorizojë vazhdimin e njohurive.
- Nxënësi ndjen nevojën të hyjë në komunikim me të tjerët, nevojën e të shprehurit, nevojën e të kuptuarit.

Në këtë rast theksi vihet në praktikën e gjuhës, në vazhdimin e njohurive bazë duke përdorur programe të reja dhe metoda të reja.

2. SYNIME EDUKATIVE DHE OBJEKTIVA DIDAKTIKË

a. Synime edukative

Në kushtet e kërkesave gjithmonë e në rritje për një përvetësim cilësor të gjuhëve të huaja, lind domosdoshmëria e ndërëgjegjësimit të nxënësve se ç' duhet të bëjë ai për të përdorur gjuhën në mënyrë efikase.

Strategjitë e të mësuarit të gjuhës përfshijnë të gjithë komponentët: leximin, dëgjimin, shkrimin dhe komunikimin.

Së bashku me gjuhën e huaj nxënësit marrin informacion edhe për kulturën, pjesë e së cilës është kjo gjuhë e huaj.

Dimensioni kulturor është një komponent shumë i rëndësishëm që ndikon në ndërtimin e kompetencave të komunikimit. Pra nxënësi mëson rregullat e mirësjelljes, normat shoqërore, respektin ndaj njëri-tjetrit etj.

b. Objektiva didaktive

Objektivi komunikues

Lehtësia me të cilën njëri i jashtë shtetit mësojnë gjuhën e huaj, argumentohet në një pjesë të mirë të saj me faktin se fjalët dhe strukturat përvetësohen më shumë gjatë kryerjes së një veprimi të gjallë sesa duke lexuar në një metodë. Prandaj ka shumë rëndësi të mësuarit aktiv të gjuhës së huaj në shkollë.

Në klasën e 7-të një vend të rëndësishëm zë edhe arsyeja. Mësuesi i gjuhës së huaj ndërton dhe përpunon lëndën mësimore, e përshtat atë për situata të ndryshme që

ta bëjë më të lehtë këtë mësim duke krijuar hapësira komunikuese të ngjashme me ato të jetës së përditshme.

Objektivi gjuhësor

Në këtë fazë fillojnë dhe nguliten rregulla dhe dalngadalë ndrihet skeleti, ndarjet dhe riorganizimi i gjuhës së huaj. Nxënësi fillon të ndërgjegjësohet për ligjshmërinë gjuhësore kurse mësuesi krijon situata dhe mundësi që nxënësi t'i përdorë këto struktura.

Kur nxënësi arrin të përdorë saktë një strukturë gjuhësore, fiton një lloj sigurie dhe arrin vetë të kuptojë ç'është e rregullt dhe jo e rregullt. Njohuritë gjuhësore kanë tani një rëndësi krejt tjetër ndaj të folurit spontan në krahasim me ndjesitë gjuhësore të nivelit fillestar.

Objektivi socialkulturore

Strukturat gramatikore e leksikore përvetësohen më mirë të vendosura në kontekst. Integrimi i elementeve të qytetërimit në përvetësimin e gjuhës së huaj shton motivimin e nxënësve duke i çuar ata në një realitet tjetër të ndryshëm nga ai ku jeton. Ai ngjall interesin, kërkësin për vendin, gjuhën e të cilit është duke mësuar, për zakone, rite, norma të ndryshme nga të vetat. Ai zgjeron njohuritë dhe kulturën e tij të përgjithshme.

3. PËRSHKRIMI I KATËR AFTËSIVE GJUHËSORE

Realizimi i komunikimit realizohet nëpërmjet zhvillimit të katër shprehive gjuhësore të harmonizuara në procesin mësimor. Mësuesi i përdor përshkrimet e niveleve për të përcaktuar shkallën e përvetësimit të njohurive tek nxënësit. Këto aftësi janë:

- Të dëgjuarit
- Të folurit
- Të lexuarit
- Të shkruarit

Të dëgjuarit:

- Kap thelbin në mesazhe të shkruartra dhe të thjeshta, si dhe në njoftime shkollore.
- Kap informacioni bazë në pjesë të shkurtra që merren me çështje të përditshme kur flitet ngadalë dhe qartë.
- Dallon dhe përcakton thelbin në ndonjë lajm, për ndodhi të ndryshme, në njoftime televizive kur shoqërohen me figurë dhe komente të ndryshme.
- Ndjek biseda të ndryshme të artikuluara qartë që i drejtohen atij dhe shpesh kërkon përsëritje të fjalëve dhe shprehjeve të veçanta.

Të folurit:

- Komunikon me ndihmën e disa shprehjeve të thjeshta ose të disa frazave të mësuara më parë.

- Diskuton me dikë për çka do të bëjë dhe ku do të shkojë, lë orën dhe vendin e takimit.
- I drejtohet dikujt për një informacion dhe tregon kur e kupton ose jo.
- Përballon disa situata në të cilat ndodhet gjatë një udhëtimi në vendin ku flitet gjuha që mësohet për të plotësuar nevojat e veta.
- Bën një bisedë të thjeshtë me tema që paraqesin interes për të, si: puna, shkolla, koha e lirë kur gjuha që përdoret, është e qartë dhe me ritëm normal nga ana e bashkëbiseduesit.

Të lexuarit:

- Lexon dhe kupton tekste të shkurtra, të thjeshta me një fjalor të përdorshëm, në tekste të tilla si njoftime, reklama, meny, orare dhe nxjerr informacionin që dëshiron.
- Gjen dhe kupton informacionin apo faktet e kërkuara psh. Kush, ku dhe kur është kryer diçka.
- Kupton informacionin më të rëndësishëm nga broshura të shkurtra, të thjeshta me informacion të jetës së përditshme.
- Kupton tekste të shprehur më gjuhë të përdorimit të përditshëm.

Të shkruarit:

- Shkruan të dhëna të thjeshta, të shkurtra për një person të njohur ose imagjinar.
- Shkruan një seri shprehjesh dhe fjalish rreth familjes së tij, kushteve të jetesës, formimit arsimor.
- Përshkruan një ngjarje në fjali të thjeshta për një gazetë shkolle.
- Shkruan struktura të thjeshta duke gabuar herë pas here, si, p.sh., në përdorimin e kohëve, por jep zakonisht qartë atë çka përpiket të shprehë.
- Shkruan hartime të shkurtra duke përdorur fjalorin për tema të njohura.
- Përshkruan motin, stinët.
- Krijon mikrodialogje.

4. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

Struktura vjetore e klasës së 7-të

$$35 \text{ javë} \times 2 \text{ orë} = 70 \text{ orë}$$

Përsëritje në fillim të vitit	4 orë
Mësime të reja	54 orë
Përsëritje gjatë vitit	4 orë
Detyra me shkrim	2 orë
Lexime të pavarura	2 orë
Bisedë e lirë	4 orë

70 orë

5. STRUKTURA ANALITIKE E PROGRAMIT

- **Përsëritje në fillim të vitit (4 orë)**

Përsëritja në fillim të vitit ka për qëllim rikujtimin e njohurive bazë leksikore dhe gramatikore të marra gjatë vitit paraardhës, mbi të cilat do të mbështeten njohuritë e reja të këtij viti shkollor. Përzgjedhja i lihet mësuesit në vartësi të nevojave të nxënësve.

- **Mësime të reja (54 orë)**

Mësuesi është i lirë që çdo mësim ta planifikojë vetë në sa orë do ta ndërtojë. Kjo është në varësi me nivelin e klasës ku ai jep mësim.

- **Përsëritje gjatë viti (4 orë)**

Ka për qëllim ngulitjen e strukturave më të rëndësishme gramatikore e leksikore dhe përdorimin e tyre në situata të tjera.

- **Detyra me shkrim (2 orë)**

Detyrat me shkrim nuk kanë qëllim vetëm vlerësim të njohurive, por e lejojnë nxënësin të ndërtojë njohuritë për arritjet dhe mangësitë e tij që të ndërtojë punën për t'i mënjeluar ato.

- **Lexime të pavarura (2 orë)**

Përdorimi i pjesëve letrare nuk është vetëm një variant i mirëpritur dhe një bashkëbisedim i këndshëm larg mësimin tradicional, por edhe një motivim i duhur për përfitimin gjuhësor si nga ana e të folurit, ashtu edhe nga ana e të shkruarit.

Parapëlqehen tregime me figura, mbasi ato i afrohen më tepër shijeve të nxënësve dhe janë më të thjeshta për t'u komentuar.

- **Bisedë e lirë (4 orë)**

Temat e bisedave zgjidhen në mënyrë të atillë që lejojnë të mbahet parasysht pasuria dhe diversiteti i kulturave të të dyja gjuhëve (amtare, frënge). Zhvillohet komunikim dhe shkëmbimi ndërmjet të rinjve. Ato japin një fotografi të shoqërisë franceze dhe shqiptare dhe kanë për qëllim t'i bëjnë të flasin nxënësit, të veprojnë më një mjedis ndërkulturor.

a. Temat

Përmbajtja e programit bëhet në formë spirale duke u mbështetur në klasën e 6-të dhe duke i thelluar dhe pasuruar këto njohuri.

Temat:

- a. **Jeta e përditshme**

- Punët e shtëpisë në familje.

- Festat, ditëlindjet në familje.
- Blerjet – paraja – çmimet.
- Veshjet.
- Një ditë tipike në një familje.

b. Jeta personale

- Një ditë në shkollë.
- Sportet.
- Detyrat në shkollë.
- Marrëdhëniet ndërmjet shokëve dhe shoqeve.

c. Natyra, mjedisi

- Gjeografia, shtete, qytetet.
- Pejsazhi, natyra.

d. Mjetet e komunikimit

- Revista, gazeta, televizori.
- Telefon, e – mail.
- Udhëtime turistike.

b. Aktet dhe funksionet e komunikimit

- Exprimer la nécessité, l'obligation: je suis obligé(e) de ... + infinitif.
- Il faut + infinitif.
- Je voudrais + infinitif
- Exprimer ses besoins: j'ai besoin de + nom + infinitif.
- Exprimer son regret: je suis désolé(e) ...
- Demander et donner de l'aide: pouvez – vous m'aider à ...
- Demander la permission: je pourrais, je pex utiliser votre téléphone.
- Refuser la permission: je regrette ...
- Exprimer la satisfaction: je suis heureux de ..., je suis enchanté(e), je suis fou de joie, c'est formidable.
- Exprimer le mécontentement: je suis en colère, je suis fâché(e).
- Demander des informations sur quelque chose, sur le prix, etc.
- Demander son chemin.
- Exprimer un itinéraire.
- Répondre à une excuse: ce n'est pas ta faute.
- Faire faire qqch: vous pouvez ouvrir la fenêtre s'il vous plaît, pardon vous pouvez me passer le sel (demander à autrui de faire qqch).
- Demander de l'aide: vous pouvez m'aider à trouver ...

c. Strukturat gramatikore

- Les pronoms relatifs : qui, que, ou.
- Les pronoms personnels : COD (le, la, les).
- Les pronoms personnels : COI (lui, leur).

- Les adverbes en, y.
- L'imparfait.
- Les conjonctions : et, mais, ou, donc.
- Les verbes du 3^{ème} groupe.
- Le comparatif simple : plus ... que, moins ... que, aussi ... que.
- Articulateurs chronologiques : d'abord, ensuite, enfin.
- Pronoms toniques : moi, toi, lui.
- Verbes : dormir, courir, partir, répondre, etc.
- Les structures interrogatives : quand, comment, pourquoi.
- Formules de politesse : le conditionnel.
- Mise en relief : ton père il est chauffeur.
- Le féminin des noms de métier : boulanger – boulangère, acteur – actrice, chanteur – chanteuse.
- Le superlatif : Le plus beau, le(la) meilleur(e).
- Articles contractés avec à et de : au, à la, aux, du, de la, des.

Fonologji:

Fonetika ka për qëllim të përsosë aftësitë e nxënësit për një shqiptim të saktë të fjalëve dhe fjalive me intonacionin dhe muzikalitetin e duhur.

6. UDHËZIME DIDAKTIKE

Me hartimin e kurrikulave të reja të gjuhëve të huaja, mësuesi është i lirë të zgjedhë metodën që dëshiron për të përdorur, mjafton që të realizojë programin dhe objektivat e parashikuar. Në metodat e reja komunikuese nxënësi gjen vetveten dhe është më i lirshëm për t'u shprehur. Parapëlqehet puna në grup, mbasi informacioni përgatitet nga të gjithë dhe përgjegjësia për suksesin apo humbjen u takon të gjithëve, gjë që i ndihmon të ndihen të bashkuar dhe njësoj të vlerësuar.

Roli i nxënësit bëhet evident duke qenë se ai, në pozicion qendror në procesin e të mësuarit, hyn në marrëdhënie ndërveprimi, komunikimi me nxënësit e tjerë. Kjo arrihet nëpërmjet veprimtarive të tilla mësimore, si: lojë, dramatizim, veprimtari në grupe, çifte etj.

Në këto raste, roli i mësuesit ndryshon. Ai tani luan një rol mbështetës dhe nxitës të veprimtarive individuale dhe autonome të nxënësit. Mësuesi nxit dhe krijon situata reale mësimore.

7. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE VETËVLERËSIMIT

Vlerësimi i përparimit të nxënësve ka për qëllim matjen e përparimit dhe të arritjeve në gjuhë të huaj. Format e ndryshme të larmishme të vlerësimit u krijojnë mundësi nxënësve për të konsoliduar njohuritë e tyre si në klasë, ashtu edhe në shtëpi duke u dhënë detyra të studiuara, specifike me objektiva të qartë që përforcojnë dhe çojnë më tej njohuritë e fituara.

Kontrolli gojor, me gjithë karakterin e vet subjektiv, mbete një element i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve në klasë.

Ekzistojnë dy tipe të vlerësimit: formues dhe përmbledhës. Vlerësimi formues ka për qëllim të informojë mësuesin edhe nxënësin mbi pikat e dobëta që ndeshen në klasë. Ai ka shumë forma:

- Një vëmendje konstante në klasë duke nxitur të dobëtit dhe duke u dhënë atyre këshilla të nevojshme.
- Pyetje të shkurtra e të sakta.
- Qortim gramatikor dhe leksikor.
- Drejtsahkrim, respektimi i shenjave të pikësimit, pastërtia e detyrës.

Vlerësimi përmbledhës shërben të klasifikojë nxënësit duke vlerësuar përparimin e tyre dhe për të matur nivelin e njohurive. Zakonisht ky bëhet në fund të semestrit apo të viti shkollor.

Vetëvlerësimi e mundëson nxënësin të testojë njohuritë e tij nëpërmjet veprimtarive të shkurtra dhe efikase. Rezultati i ndërgjegjëson ata për arritjet dhe mangësitë duke i ndihmuar për t'i kapërcyer ato.

Ja një shembull vetëvlerësimi:

- Plotësoni me je, tu, il vous:
 - ... as 15 ans
 - ... apprend le français à Paris

**Ju keni 5 pikë.
Urime!**

**Më pak se 5 pikë.
Duhet të përsëritni
përemrat vectorë.**

Një tjetër formë e vlerësimit të shprehjeve me gojë dhe me shkrim.

Me gojë:

- **Vlera komunikuese**
 - Marrja në konsideratë e situatës 0 – 2 pikë.
 - Logjika dhe koherenca e përmbajtjes 0 – 2 pikë.
 - Origjinaliteti 0 ose 1 pikë.
- **Vlera gjuhësore**
 - Qortimi gramatikor dhe leksikor 0 – 2 pikë.
 - Shqiptimi 0 – 2 pikë.
 - Shprehjet idiomatike 0 ose 1 pikë.
 - Maksimumi i mundshëm 10 pikë.

Me shkrim:

- **Vlera komunikuese**
 - Marrja në konsideratë e situatës dhe zgjedhjes së informacionit (kush e shkruan, kujt, për çfarë, pse) 0 – 4 pikë.
 - Organizimi i tekstit, logjika e tij 0 – 4 pikë.
 - Origjinaliteti 1 ose 2 pikë.
- **Vlera gjuhësore**
 - Qortimi gramatikor 0 – 3 pikë.
 - Qortimi leksikor 0 – 2 pikë.
 - Paraqitja, drejtshkrimi, përdorimi i shkronjës së madhe, shenjat e pikësimit 0 – 3 pikë.

- Krijimtaria, origjinaliteti i saj 0 – 2 pikë.
Maksimumi i mundshëm 20 pikë.

8. KRITERE TË HARTIMIT TË TEKSTIT TË KLASËS SË 7-të NË SISTEMI E SHKOLLËS 9-VJEÇARE

Për hartimin e teksti, të mbahet parasysh grup-mosha së cilës i drejtohet dhe në sa orë do të zhvillohet kjo metodë.

- Teksti të jetë i ndarë në njësi didaktike.
- Tematika e zgjedhur (të përfshihen veprimtari të jetës së përditshme sa më afër interesave të nxënësve, ku ata mund të flasin për veten e tyre, personat që i rrethojnë).
- Të jetë me materiale autentike, me ilustrime, me ngjyra.
- Të ketë strategji ndërvepruese për të zhvilluar tek nxënësit: “Unë di të bëj – savoir faire”, “Unë di të jem – savoir être”.
- Gramatika të jetë e ndërthurur me objektiva komunikimi.
- T’i përshtatet zhvillimit emocional të nxënësve.
- Të ketë format të madh për një pamje të mirë nga ana nxënësve.
- Të ketë ushtrime për zhvillimin e imagjinatës, lidhjen ndërlëndore (histori, gjeografi etj.).
- Të ketë një ekuilibër ndërmjet veprimtarisë individuale dhe kolektive.
- Të mbështetet në 4 kompetencat.
- Rubrika “Civilisation” (qytetërimi) i ndërgjegjëson nxënësit për pasurinë dhe diversitetin e kulturës botërore dhe nxit tek ata dëshirën për të hyrë në komunikim me të rinjtë e moshës së tij.
- Metoda të shoqërohet me kasetë dhe me libër mësuesi.
- Pra, teksti të jetë i mbështetur mbi objektiva të qartë, si:
 - Të mësosh të komunikosh në gjuhën frënge me gojë dhe me shkrim.
 - Të mësosh funksionimin progresiv të gjuhës.
 - Të njohësh Francën dhe botën frankofone duke krahasuar kulturën dhe zakonet e saj me tonat.
 - Teksti të propozojë teknika dhe strategji që lehtësojnë mësimdhënien dhe e çojnë nxënësin në një autonomi të vetes.

Teksti të jetë me katër ngjyra.
Teksti të ketë 150 faqe A4
Formati të jetë 260 x 200 mm.